



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 18 (827923)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 9 maj 2025

Ministri Vengu: Ushtria Shqiptare, Gardiane e Kujtesës Kombëtare



faqe 3



SHSHPPFA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI: NDERIM DËSHMORËVE TË KOMBIT, MIRËNJOHJE PËR SAKRIFICËN DHE FRYMËZIM PËR TË ARDHMEN

Në Ditën e Dëshmorëve të Atdheut, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përkulen me nderim të thellë përpara kujtimit të të gjithë atyre burrave dhe grave që u flijuan për lirinë, pavarësinë dhe dinjitetin e vendit tonë. Ndër ta, një vend të veçantë zënë Dëshmorët e Atdheut nga radhët e Forcave të Armatosura...



faqe 2



“112 VJET LAVDI DHE SAKRIFICË – SHTABI I PËRGJITHSHËM, ZEMRA E USHTRISË SHQIPTARE!”

112 vjet nga krijimi i Shtabit të Përgjithshëm Ushtria Kombëtare e shtetit shqiptar është ngritur 110 vjet më parë, krahas Ministrisë të Luftës/Mbrojtjes. UKSH-ja ka pasur në drejtim shtatmadhorët dhe Shtatmadhorinë e saj. Tradita luftarake shqiptare ka ekzistuar që nga ushtritë ilire, në ushtrinë e Gjergj Kastriotit...



faqe 8



5 MAJI, KUJTESË, NDERIM DHE PËRGJEGJËSI NDAJ DËSHMORËVE TË ATDHEUT

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Për Ty, Atdhe, dhanë jetën qindra djem dhe vajza Shqipëria jonë, kjo tokë e lashtë e ngrohur nga dielli i lirisë dhe larë me gjakun e bijve të saj më të mirë është sot e lirë, sepse shumë të rinj, djem e vajza...



faqe 6

U zhvillua Konferenca e Nënoficerit: “Roli i nënoficerit në menaxhimin e trupës profesionale në FARSH, sot dhe në të ardhmen”

Në ambientet e Auditoriumit në Ministrinë e Mbrojtjes, u zhvillua konferenca e nënoficerit, me temë: “Roli i nënoficerit në menaxhimin e trupës profesionale në FARSH, sot dhe në të ardhmen”.

Në këtë konferencë, morën pjesë ekipe nga Garda Kombëtare e New Jersey-it, Komanda e Forcave Amerikane për Europën dhe Afrikën, Forcat e Sigurisë së Kosovës, si dhe komandat e forcave kryesore, mbështetëse dhe autonome të SHPPFA-së.

Qëllimi i konferencës ishte diskutimi i rolit të nënoficerit në menaxhimin e trupës profesionale, duke u fokusuar sidomos në sfidat aktuale dhe mundësinë për të ardhmen në identifikimin e praktikave më të mira, adresimin e sfidave, promovimin e zhvillimit profesional dhe bashkëpunimit në nivele të ndryshme komandimi, partneriteti, etj.

Punimet e kësaj konference u përshëndetën nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili pasi falënderoi të gjithë të pranishmit theksoi rolin jetik të nënoficerit në përgatitjen cilësore të trupës profesionale, duke qenë ata që përcaktojnë ritmin, seriozitetin dhe standardin e çdo procesi gatishmërie, stërvitje dhe operacioni në repartet tona.

“Roli i nënoficerit shqiptar sot, nuk kufizohet vetëm brenda repartit. Ai është aktor i drejtpërdrejtë nga stërvitjet bazë, të avancuara, shumëkombëshe, në bashkëpunim rajonal dhe operacionet ndërkombëtare e humanitare, ku FARSH kontribuon me përgjegjësi dhe nder. Nga KFOR-i në Kosovë, tek operacionet paqeruajtëse të BE-së në BiH, nga Letonia në Bullgari, nga Deti Egje në Sudan të Jugut, Egjipt dhe më gjerë, nënoficeri ynë është shembulli i përkushtimit, profesionalizmit dhe përfarësimit dinjitoz të vendit...”, - u shpreh gjenerallejtënant Kingji.

Gjatë fjalës së tij në këtë konferencë, SHSHPPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji, adresoi një falënderim të veçantë për Gardën Kombëtare të New Jersey-it, për mbështetjen e çmuar në zhvillimin e nënoficerit të FARSH-së, nëpërmjet trajnimeve, këshillimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta në kuadër të Programit të Partneritetit, po ashtu edhe një falënderim edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës, për bashkëpunimin e shkëlqyer në fushat e stërvitjes, arsimimit, operacioneve të përbashkëta si dhe theksoi se ky partneritet dhe bashkëpunim do vijojë të njohë rritje dhe në interes të forcimit të rolit lider të nënoficerit në FA.

Në përfundim të fjalës së tij, gjenerallejtënant Kingji kërkoi më shumë përkushtim e cilësi në përgatitjen e trupës profesionale, më shumë vetëzhvillim profesional, më shumë përgjegjësi në ruajtjen e disiplinës dhe etikës ushtarake, si dhe më shumë rol pro-aktiv, në çdo grup stërvitor, situatë e aktivitete të FARSH-së, duke nënvizuar se vetëm nëpërmjet jush do të kemi një forcë më të gatshme, më të besueshme dhe më të aftë për të përballuar sfidat e sotme dhe të nesërme.



Gjeneralmajor Ferdinand Dimo merr pjesë në takim të komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s

Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, mori pjesë në takim dy ditor të komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s, zhvilluar në Qendrën e Planifikimit të Operacioneve Ajrore në Lion, Francë.

Qëllimi i këtij takimi ishte ndarja e mendimeve dhe reflektimi mbi kuptimin e garancive të sigurisë për Ukrainën për sa i përket fushës ajrore dhe njohjen me planet reale dhe ato mbështetëse të forcave të koalicionit në rast situatë luftarake.





Forcat e Armatosura në Shërbim të Amanetit të Dëshmorëve, mesazhi i Ministrit të Mbrojtjes Piro Vengu:

Të nderuar familjarë të dëshmorëve,

Të nderuar pjesëtarë të Forcave të Armatosura!

Sot, më 5 Maj, ne përulemi me nderim dhe mirënjohje të thellë përpara kujtimit të dëshmorëve tanë – bijve dhe bijave më të mirë të kombit, që dhanë jetën për lirinë dhe dinjitetin tonë kombëtar.

Kjo ditë është më shumë se një përkujtim; është një thirrje për të mos harruar sakrificën sublime që këta burra dhe gra bënë për ne, për të ardhmen e fëmijëve tanë dhe për të drejtat që ne gëzojmë sot.

Si Ministër i Mbrojtjes, e ndjej për detyrë që të theksoj se mbrojtja e atdheut nuk ndalet me një luftë të kaluar, ajo është një përpjekje e përhershme për të ruajtur paqen, sigurinë dhe vlerat që dëshmorët tanë i shenjtëruan me gjakun e tyre.

Në emër të Ministrisë së Mbrojtjes, ju siguroj se kujtimi i tyre do të jetojë përherë në zemrat tona, duke u angazhuar për një Shqipëri më të fortë, më të drejtë dhe më të bashkuar.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve të atdheut!

Rrofshin përjetë idealet e tyre!

Ministri Vengu: Ushtria Shqiptare, Gardiane e Kujtesës Kombëtare



SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Nderim Dëshmorëve të Kombit, Mirënjohje për Sakrificën dhe Frymëzim për të Ardhmen

SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Në Ditën e Dëshmorëve të Atdheut, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përkulen me nderim të thellë përpara kujtimit të të gjithë atyre burrave dhe grave që u flijuan për lirinë, pavarësinë dhe dinjitetin e vendit tonë.

Ndër ta, një vend të veçantë zënë Dëshmorët e Atdheut nga radhët e Forcave të Armatosura, të cilët në çdo etapë të historisë sonë moderne, nga misionet kombëtare e deri te misionet ndërkombëtare për ruajtjen sigurisë dhe paqes, dhanë jetën për mbrojtjen e vlerave euroatlantike që ne përfaqësojmë. Sakrifika e tyre përfaqëson themelet mbi të cilat është ndërtuar siguria jonë kombëtare dhe orientimi ynë strategjik si shtet modern. Ajo mbetet një kujtesë e përhershme e çmimit të lirisë dhe një thirrje për vazhdimësinë e përkushtimit tonë institucional.

Forcat e Armatosura, si garant i mbrojtjes dhe stabilitetit, janë të vendosura të nderojnë këtë trashëgimi me përgatitje, profesionalizëm dhe besnikëri ndaj misionit kushtetues dhe çështjeve të sigurisë rajonale e më gjerë. Kujtimi i dëshmorëve nuk është vetëm pjesë e historisë sonë, por një pjesë aktive e identitetit tonë ushtarak dhe shoqëror.

Në këtë ditë përkujtimore, nderimi ynë shkon edhe për familjet që mbajnë mbi supë dhimbjen dhe krenarinë e një sakrifice të përjetshme. Ato janë një shtyllë morale e forcës sonë kolektive dhe një dëshmi e qartë se liria është një përpjekje, që kërkon përkushtim brez pas brezi. Dëshmorët e Atdheut janë drita që ndriçon rrugën tonë si Forcë e Armatosur dhe si komb. Kujtimi i tyre frymëzon çdo brez të ri ushtarak të shërbejë me nder, sakrificë dhe vendosmëri. Lavdia e tyre është përgjegjësia jonë, një detyrim për të ruajtur dhe çuar përpara vlerat më të larta të lirisë, dinjitetit dhe zhvillimit të Atdheut.

Lavdi përjetë Dëshmorëve të Atdheut!

Anëtarë të Kongresit të SHBA vizitojnë Forcën Tokësore

Përfaqësues të Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) zhvilluan një vizitë në garnizonin Zall-Herr në Komandën e Forcës Tokësore.

Gjatë kësaj vizite, fillimisht ekipi u njoh me misionin, detyrat, stërvitjet kryesore dhe kontributet në misione të Forcës Tokësore në kuadër të NATO-s dhe BE-së, në mbështetje të paqes dhe sigurisë.

Më pas ata panë nga afër donacionet amerikane në mjete, pajisje e teknikë, dhuruar për Grup Batalionin e Këmbësorisë së Lehtë (GBKL) dhe njësi të tjera të Forcës Tokësore.

Vizita vijoi me një demonstrim nga Qendra Stërvitore me qitje me armët e këmbësorisë, një nga kapacitetet më të fundit ardhur në Forcën Tokësore vetëm disa javë më parë. Në përfundim u tregua dhe një ekspozim statik (static display) i armatimit, pajisjeve dhe mjeteve speciale nga batalioni i këmbësorisë së lehtë, Qendra e Mbrojtjes nga Armët e Dëmtimit në Masë (Q MADM) dhe EOD.

Anëtarët e këtij ekipi u falënderuan nga Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Ilir Xhebexhia për mbështetjen e vazhdueshme nëpërmjet kurseve, trajnimeve dhe donacioneve të rëndësishme, e cila reflekton bashkëpunimin e ngushtë dhe angazhimin për rritjen e kapaciteteve operacionale të Forcës Tokësore.



Operatorët EOD përmbyllin me sukses operacionet në bashkitë Pogradec, Durrës dhe Tiranë

Përfunduan me sukses tre operacione për vlerësimin, largimin, asgjësimin dhe transportimin e municioneve të paplasura, në mbështetje të emergjencave civile në bashkitë Pogradec, Durrës dhe Tiranë. Ekipi EOD, i angazhuar në operacion në fshatin Gurras, njësia administrative Buçimas, bashkia Pogradec, konstatoi se municioni i gjetur tip predhë mortaje ishte i prekshëm dhe i lëvizshëm. Ekiye të tjera EOD, kryen veprime të specializuara për identifikimin dhe vlerësimin e municioneve të gjetura në afërsi të zonave të banuara në bashkitë Durrës dhe Tiranë. Me profesionalizëm ata konstatuan se municionet e gjetura i përkisnin kalibrave të ndryshëm dhe ishin të lëvizshëm. Duke zbatuar të gjitha rregullat e sigurimit teknik dhe procedurat e parashikuara në manualet përkatëse EOD, efektivët e Batalionit të Xhenios realizuan largimin e municioneve dhe magazinimin e tyre, duke siguruar jetën dhe pronën e banorëve.



Mbyllet me sukses “Kursi Bazë i Oficerit”, specialiteti ‘furnizim’

Për më shumë se 20 javë oficerët me gradën nëntoger, kanë ndjekur “Kursin Bazë të Oficerit”, kurs institucional, i cili u zhvillua në ambientet e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse.

Me rastin e përfundimit të këtij kursi, në Qendrën Stërvitore u zhvillua ceremonia e certifikimit të kursantëve, në të cilën ishin të pranishëm shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Idriz Kuca, komandanti i Qendrës Stërvitore, kolonel Ylli Zyla dhe të ftuar të tjerë. Në fjalën e tij përshëndetëse, kolonel Idriz Kuca përgëzoi kursantët për mbylljen me sukses të këtij programi mësimor dhe njëkohësisht iu uroi suksese të mëtejshme në kurset e radhës. 15 efektivët e Forcave të Armatosura treguan përkushtim dhe angazhim maksimal, duke përvetësuar aftësi taktike, teknike dhe drejtuese në rolin e komandantit të togës. Thellimi i njohurive, përgatitja profesionale dhe ecuria në karrierën ushtarake janë disa nga objektivat e kurseve të tilla institucionale, të cilat arrihen përmes programeve arsimore bashkëkohore dhe vullnetit të instruktorëve dhe kursantëve pjesëmarrës për të shërbyer në Forcat e Armatosura si specialist furnizimi.



Në Camp Adazi dhe në Batalionin e Xhenios zhvillohen ceremoni përkujtimore në nder të dëshmorëve të rënë në krye të detyrës

Komanda Mbështetëse përkujtoi përmes një ceremonie të veçantë të organizuar në ambientet e Batalionit të Xhenios, 6-vjetorin e rënies në krye të detyrës të Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetar Zarife Hasanaj, të cilët dhanë jetën e tyre gjatë shërbimit në misionin ushtarak të NATO-s, në Letoni.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, komandanti i Batalionit të Xhenios, kolonel Shkëlzen Mhillaj, familjarë të dëshmorëve dhe efektivë të Komandës Mbështetëse.

“Të dashur familjarë, dhimbja juaj është një dhimbje e madhe dhe në këtë dhimbje le të jemi të bashkuar në nderimin e thellë për gjithçka që dëshmorët tanë na lanë, për emrin e tyre të ndritur, shembullin për t’u ndjekur dhe një borxh që nuk mund të shlyhet me fjalë, por me veprime, përkushtim dhe me qëndresë”, - ishin këto fjalë me të cilat komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando iu drejtua familjarëve, kolegëve dhe miqve të Dëshmorëve të Atdheut.

Ceremonia përkujtimore vazhdoi me vendosjen e kurorave nga familjarë dhe ushtarakë pranë monumentit të të rënëve në krye të detyrës.

6-vjetori i rënies në krye të detyrës të Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetar Zarife Hasanaj, u përkujtua dhe në ambientet e Camp Adazi, Letoni, aty ku ata dhanë jetën duke shërbyer dhe përfaqësuar Forcat tona të Armatosura.



Forca Tokësore nisi Kontingjentin KFOR – 3 në Kosovë

Në mjediset e Forcës Tokësore, u zhvillua ceremonia e përcjelljes së trupave nga Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë (bkl), të cilët do të shërbejnë në KFOR, si pjesë e misionit të NATO-s, në Kosovë.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, mori pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti, i cili pasi u uroi suksese, ndër të tjera vuri theksin në zbatimin e detyrës me rigorozitet dhe përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë, tashmë si një prodhuese e mbrojtëse e sigurisë në rajon e më gjerë.

Të pranishmit, i përshëndeti komandanti i kontingjentit kapiten Erind Pashaj, i cili pasi falënderoi për besimin e treguar, i siguroi ata se misionin që iu është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe korrektesë në çdo drejtim.

Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale së bashku me aleatët tanë ndërkombëtarë, në përfaqësimin sa më denjësisht të Forcave tona të Armatosura.



Efektivët e FA-së vlerësohen në garën “Luftëtarët më të mirë” të Gardës Kombëtare të Nju Xhersit

Tetar Joni Mino dhe nëntetar Erkan Zagani, pjesë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë vlerësuar për paraqitjen e tyre të shkëlqyer në garën “Luftëtarët më të mirë”, zhvilluar javën e kaluar nga Garda Kombëtare e Nju Xhersit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Forca Tokësore ngjitet në podium, në garën ndërkombëtare “Ushtari më i mirë i vitit 2025”, zhvilluar në Ferizaj, Kosovë



Forca Tokësore mori pjesë në garën ndërkombëtare “Ushtari më i mirë i vitit 2025”, që u zhvillua në Ferizaj, Kosovë, për një javë rresht, ku u përfaqësua nga 3 ushtarakë.

Gjatë kësaj gare u konkurrua në disa disiplina si përgatitje fizike, topografi dhe qitje me tre pozicione: në largësinë 150 m barkas, 100 m në gjunjë dhe 75 m në këmbë.

Në këtë aktivitet morën pjesë 8 shtete me një total 44 garues, ku Shqipëria, nëpërmjet Ushtarit IV Hil Mala, u ngjit në podiumin e fitores dhe zuri vendin e dytë, ndërsa Ushtar IV Manuel Ruçi u rendit në vendin e katërt dhe OR-7 u rendit në vendin e pestë.

Në nivel grupi, ekipi i Forcës Tokësore zuri vendin e parë ndër të gjithë shtetet pjesëmarrëse, duke e ngjitur Shqipërinë në podium me fitore si në garë grupi ashtu edhe atë individual.

Atdheu përjetë mirënjohës!



**ANJEZA MUSOLLARI,**
Shefe e Sektorit të Botimeve**Për Ty, Atdhe, dhanë jetën qindra djem dhe vajza**

Shqipëria jonë, kjo tokë e lashtë e ngrohur nga dielli i lirisë dhe larë me gjakun e bijve të saj më të mirë është sot e lirë, sepse shumë të rinj, djem e vajza, zgjodhën të sakrifikojnë jetën për të. Në dy luftërat botërore, kur errësira përpiquej të mbulonte dritën e popujve të vegjël, shqiptarët nuk heshtën. Ata qëndruan përballë pushtuesve me guxim, me armë në dorë e me zjarrin e atdhedashurisë në zemër.

Në Luftën e Parë Botërore, edhe pse Shqipëria ishte e brishtë, pa institucione të qëndrueshme e shpeshherë e harruar nga bota, bijtë e saj nuk e lanë tokën pa mbrojtje.

Me pak fjalë dhe shumë vepra, ata u ngritën si malet tona, krenarë, të pathyeshëm, u flijuan për të ruajtur identitetin dhe shpirtin shqiptar në kohë trazirash.

Në Luftën e Dytë Botërore, kjo flakë u përhap edhe më fuqishëm. Rinia shqiptare nuk qëndroi mënjane. Djem e vajza të moshës së re lanë bankat e shkollës, familjet dhe ëndrrat personale për të luftuar për lirinë e kombit. Ata ngjitën malet, përballuan vuajtjet, urinë dhe plumbat, por kurrë nuk u përkulën.

Ata ishin zemra e një Shqipërie që nuk pranoi të nënshtrohej. Sot, emrat e tyre qëndrojnë të skalitur në monumente dhe pllaka përkujtimore. Por më shumë se kaq, ata jetojnë në ndërgjegjen e kombit tonë, në çdo hap të lirë që hedhim dhe në çdo fjalë shqip që shqiptojmë me krenari.

Për këtë arsye, kujtimi i tyre nuk është vetëm një detyrim historik. Është një borxh shpirtëror që secili prej nesh ka ndaj tyre: të jetojmë me ndershmëri, me dashuri për vendin, duke mbrojtur paqen dhe lirinë që ata na lanë trashëgim.

Pse 5 Maji është ditë e shënuar?

5 Maji nuk është thjesht një datë në kalendar, por një ditë historike, ku kombi shqiptar ndalet në heshtje, në nderim dhe reflektim. Është dita kur ne përkulemi me mirënjohje të thellë përpara atyre që dhanë më të shtrenjtën, jetën, për lirinë, dinjitetin dhe të ardhmen tonë. Është dita e Dëshmorëve të Atdheut.

Në çdo cep të Shqipërisë, nga qytetet në fushë, deri në majat e maleve, historia ka lënë gjurmët e atyre që luftuan me zemër për të mos lejuar që vendi të mbetet nën robëri.

Lufta Nacionalçlirimtare, e cila zë një vend të veçantë në kujtesën tonë historike, u shkrua me gjakun dhe sakrificën e shumë të rinjve e të rejave, të burrave dhe grave që vendosën atdheun mbi vetveten.

Kjo datë nuk është zgjedhur rastësisht, më 5 maj 1942, në Tiranë, ra dëshmor Qemal Stafa, një prej figurave më të ndritura të rinisë shqiptare dhe ndër drejtuesit kryesorë të rezistencës antifashiste. Vrasja e tij nga forcat fashiste italiane tronditi opinionin publik dhe galvanizoi më tej lëvizjen për çlirim kombëtar. Prej atij momenti, emri i tij u kthye në simbol të sakrificës për idealin e lirisë dhe drejtësisë.

Kjo datë e rëndësishme, nuk është veç kujtesë historike, por një thirrje që na rikujton se liria dhe pavarësia nuk janë dhuratë, por është sakrificë dhe jetë e dhënë. Ato janë arritje që duhen mbrojtur me përgjegjësi, me angazhim qytetar dhe me përkushtim ndaj vlerave demokratike. Dëshmorët nuk ranë për një Shqipëri të përçarë, të padrejtë apo të varfër në ideale. Ata ëndërruan një atdhe ku drejtësia, barazia dhe dinjiteti njerëzor janë baza e shoqërisë.

Sot, ne e kemi për detyrë që këtë trashëgimi të mos e harrojmë.

Të rinjtë duhet të mësojnë historinë, jo si ngarkesë mësimore, por si pjesë e identitetit të tyre kombëtar.

Institucionet kanë detyrimin të kujtojnë dhe nderojnë dëshmorët, jo vetëm përmes ceremonive

5 MAJI,

Kujtesë, Nderim

dhe Përgjegjësi ndaj

Dëshmorëve të Atdheut

**Hasan Xhaferr Rakipi**
1928-1953

formale, por përmes politikave që ndërtojnë një shoqëri më të drejtë dhe më të zhvilluar.

Le të jetë 5 Maji, çdo vit, një ditë jo vetëm për të vendosur kurora në përmendore, por për të vendosur veten përballë pasqyrës së ndërgjegjes kombëtare. Sepse më i madh është ai nder që i bëjmë dëshmorëve përmes veprës sonë, sesa përmes fjalëve.

Në këtë ditë të shenjtë, përulem me nderim para të gjithë atyre që ranë në altarin e lirisë. Por sot, më lejoni ta ndaj edhe si një ditë të veçantë për mua dhe familjen time. Sepse ndër emrat që kujtohen me respekt sot, është edhe gjyshi im, një nga dëshmorët e këtij Atdheu.

Gjyshi im dha jetën për liri në moshën 27-vjeçare, por historia e tij, qëndresa e tij, dhe vendosmëria për të mos u përkulur para padrejtësisë, janë gjurmë të pashlyeshme në shpirtin tim dhe të gjithë familjes sonë. Ai nuk kërkoi as lavdi, as përfitime. Ai zgjodhi lirinë. Zgjodhi të jetojë përjetësisht në zemrat e brezave që erdhën pas.

Ky akt heroik nuk është thjesht një krenari familjare, është një barrë e shenjtë që na kujton se liria ka një çmim dhe se për këtë liri dikush dha gjithçka.

Ne sot jetojmë dhe ndërtojmë falë gjakut të derdhur nga të rinj dhe të reja që ëndërruan një Shqipëri më të mirë. Për këtë arsye, le të mos jetë 5 Maji vetëm një datë për homazhe, por një ditë reflektimi.

Sot, përulemi me respekt dhe themi me zë të plotë: Lavdi të përjetshme dëshmorëve të Atdheut! Ata nuk ranë – ata u bënë dritë.

Lavdi të përjetshme të gjithë dëshmorëve të kombit! Nder dhe mall i përjetshëm për gjyshin tim dhe për çdo hero që jeton në kujtesën tonë!

Historia e Luftës Nacionalçlirimtare e popullit shqiptar (1939–1944), nuk mund të shkruhet pa përmendur rolin madhor të grave shqiptare, të cilat u rreshtuan krah burrave në betejat për çlirim kombëtar, shpesh duke kaluar kufijtë e asaj që koha u lejonte. Në një shoqëri ku roli i gruas ishte tradicionalisht i kufizuar në familje, luftëtarja shqiptare u shndërrua në simbol të guximit, qëndresës dhe përkushtimit ndaj Atdheut.

Kontributi në fushën e betejës

Mbi 6 000 gra morën pjesë si partizane në formacionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ato luftuan me armë në dorë, komanduan çeta dhe batalione, morën pjesë në aksione të drejtpërdrejta dhe shumë prej tyre ranë dëshmore.

Roli organizativ dhe propagandistik

Gratë nuk ishin vetëm luftëtare. Ato ishin organizatore të lëvizjeve antifashiste në qytete dhe fshatra, shpërndanë trakte, strehuan partizanë, organizuan protesta dhe sabotime ndaj pushtuesve. Ato ndihmuan në mbledhjen e fondeve, veshmbathjeve dhe ushqimeve për frontin, dhe krijuan një rrjet të gjerë rezistence civile.

Në vitin 1942, u formua Bashkimi i Grave Antifashiste të Shqipërisë, i cili mblodhi rreth vetes mijëra gra nga gjithë vendi. Ky organizim ndihmoi jo vetëm në kontributin e tyre gjatë luftës, por edhe në emancipimin e tyre politik dhe shoqëror.

Pas luftës: nga armët në ndërtimin e shtetit

Shumë nga këto gra vijuan të kontribuojnë edhe pas luftës, duke marrë poste në administratë, arsim, shëndetësi, dhe politikë. Disa u bënë deputete të para në Kuvendin Popullor, duke përfaqësuar zërin e grave shqiptare në një kohë kur pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje ishte e rrallë në botë.

Trashëgimia e tyre

Sakrifika e grave shqiptare në Luftën Nacionalçlirimtare nuk është thjesht një akt heroik i së kaluarës, ajo është mësim për brezat, një dëshmi e fuqishme që liria nuk ka gjini. Historia e tyre na mëson se ndër luftëtarët më të mëdhenj të Shqipërisë ishin gratë që heshtën, por kurrë nuk u dorëzuan.

Në çdo rrugë, në çdo fshat, në çdo mal ku u zhvillua lufta, ka pasur një grua që sakrifikoi diçka: jetën, rininë, mëmësinë, emrin. Ato janë heroinat e heshtura të kombit, të cilat na mësojnë se guximi nuk kërkon zë të lartë – kërkon vetëm zemër të madhe.

Gratë shqiptare dhanë kontribut të jashtëzakonshëm dhe sakrifikuan gjithçka në emër të lirisë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare. Secila përfaqëson një aspekt të veçantë të gruas shqiptare në luftë: vendosmërinë, sakrificën, inteligjencën dhe dashurinë për Atdheun. Disa prej grave që lanë gjurmë të thella në kujtesën historike të popullit shqiptar janë:



Margarita Tutulani (1925-1943)
- Drita që nuk u shua nga errësira

Bijë e një familjeje intelektuale beratase, Margarita u rrit me idealet e lirisë dhe barazisë. Ajo ishte pjesë e organizimit të rinisë antifashiste dhe ndihmoi në shpërndarjen e

Gratë Shqiptare në Luftën Nacionalçlirimtare – Heroina të Panjohura të Lirisë

trakteve e organizimin e protestave kundër pushtuesve italianë. Bashkë me vëllain e saj Kriston, Margarita u kap nga fashistët dhe u torturua për ditë me radhë. Asnjëri nuk foli. U vranë më 6 gusht 1943 dhe u lanë në rrugët e qytetit për të trembur popullin. Por ajo vdekje solli revoltë, jo frikë. Margarita jeton si simbol i rezistencës intelektuale dhe shpirtërore të gruas shqiptare.



Liri Gero (1926-1944) -
Vajza që u dogj e gjallë për lirinë

Me origjinë nga një familje patriotike në Fier, Liri Gero u bashkua me partizanët në moshë shumë të re. Mori pjesë në aksione dhe marshime të gjata me Çetën Partizane të Vjosës. Në një nga betejat, u kap nga forcat gjermane dhe u dogj e gjallë së bashku me disa shoqe të saj. Ajo nuk tregoi asgjë, nuk kërkoi mëshirë – vdiq si heroinë, me emrin e Shqipërisë në buzë. Sot, Liri Gero është figurë e përjetshme e guximit të një vajze që zgjodhi të digjej, por jo të dorëzohej.



Ramize Gjebrea (1923-1944)
- Luftëtarja që u dënua nga të vetët

Ramizja ishte partizane, intelektuale, aktiviste. Ajo mori

pjesë në disa aksione në jug të Shqipërisë dhe ishte ndër gratë më të përkushtuara të Luftës. Por historia e saj u bë tragjike: u përjashtua nga radhët partizane dhe u ekzekutua nga shokët e saj me motivacion “shkelje të moralit të kohës”, për shkak të një lidhjeje dashurie. Më vonë, figura e saj u rehabilitua dhe u njoh sakrifika e saj.

Ramize Gjebrea mbetet dëshmi e dhimbshme e çmimit që gratë paguan edhe për dashurinë, përveç lirisë.

Nexhmije Ismailati
- Motra që mbajti armën dhe plagët

Nga Elbasani, Nexhmija ishte pjesëtare e batalionit partizan dhe mori pjesë në disa beteja të rëndësishme. Ishte infermiere, informatore dhe luftëtare. Ajo shpëtoi jetë me duart e saj, dhe në një rast, edhe pse e plagosur rëndë, nuk pranoi të dorëzohej. Jetoi për të treguar historinë e atyre që nuk u panë, por që bënë diferencën në prapavijë.

Nexhmija përfaqëson mijëra gra të thjeshta që nuk u bënë të njohura, por që pa to lufta nuk do të kishte fituar.



Xhevë Lladrovci (1945-1992)
- Heroina që luftoi për Kosovën

Edhe pse nuk është pjesë e Luftës Nacionalçlirimtare të 1940-ës, përmendet shpesh në vazhdimësinë e gruas shqiptare që lufton për liri. Ajo ishte luftëtare e hershme për çlirimin e Kosovës, pjesë e lëvizjes ilegale në vitet '80 dhe bashkëshortja e heroit Zahir Pajaziti. Vdiq e re, por e pathyeshme në ideal. Xhevë Lladrovci na kujton se gruaja shqiptare nuk ndaloi së luftuari për lirinë edhe pas vitit 1944.

Gratë shqiptare gjatë Luftës Nacionalçlirimtare nuk ishin viktimat të rrethanave, ato ishin aktore të historisë, me vullnet, guxim dhe vetëdije. Sakrificat e tyre, jeta, rinia, dashuria, nderi, fëmijët janë pasuria më e madhe morale që i kemi lënë brezave që vijnë.

Lavdi grave që luftuan për Shqipërinë! Lavdi atyre që ranë dhe atyre që jetuan për të treguar se gruaja shqiptare është forcë e pandalshme në histori!

112 vjet nga krijimi i Shtabit të Përgjithshëm

Ushtria Kombëtare e shtetit shqiptar është ngritur 110 vjet më parë, krahas Ministrisë të Luftës/Mbrojtjes. UKSH-ja ka pasur në drejtim shtatmadhorët dhe Shtatmadhorinë e saj. Tradita luftarake shqiptare ka ekzistuar që nga ushtritë ilire, në ushtrinë e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, në atë të Pashallëqeve të Bushatllinjve dhe Ali Pashë Tepelenës tek Lidhja Shqiptare e Prizrenit, që janë faqe të ndritura të historisë dhe traditës ushtarake shqiptare. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të një shteti të pavarur, në Shqipëri, u formua më datën 4 maj 1913, në Vlorë. Formimi i Shtabit Madhuer u bë me miratimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Ai mban fillimisht emërtimin Shtati Madhnuer dhe më tej u emërua “Shtabi Madhuer”, kryetar i të cilit ishte major Ali Shefqet Shkupi. Shtabi Madhuer e kishte qendrën në Vlorë, pranë Ministrisë së Luftës të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës që kryesohej nga Ismail Qemal bej Vlora. Në verën e vitit 1913, ky shtab ishte fare i vogël, ai përfaqësohej nga një zyrë që emërohej Zyra e Shtatit Madhnuer të Ushtrisë, pranë Ministrisë së Luftës dhe ishte në përbërje e në varësi të kësaj ministrie. Në pikëpamje organizative Shtabi Madhor përbëhej nga “pjesët e nënzëshme” që emërtohej në terminologjinë e fillim shekullit të kaluar si: “Qarqet e Shtatit Madhnuer, Sekretaria e Shtatit Madhnuer, Komisioni i rregulloreve e i ushtrimeve, Komisioni i trajnimit të policisë e të xhandarmërisë, Komisioni i ndërtimit”. Shtabi Madhor ishte konceptuar, ndërtuar, por edhe veproi teorikisht e praktikisht si një organ bazë i Ministrisë së Luftës. Shtabi ishte përgjegjësi kryesor për organizimin, përgatitjen dhe drejtimin profesional të veprimtarisë luftarake të FA-ve shqiptare. Nga Shtabi kalonin të gjitha projektet e raportet për Ministrinë e Luftës, që i dërgoheshin asaj nga ana e zyrave apo edhe nga vetë qarqet e tjera ushtarake. Shtabi në këtë periudhë u mor drejtpërdrejt edhe me çështje dhe probleme që kishin lidhje me organizimin dhe kryerjen e luftimeve në mbrojtje në pjesën jugore e juglindore të Shqipërisë kundër shovinistëve grekë, dhe në pjesën verilindore. Shtabi Madhor ishte përgjegjës për furnizimin me armatime, municione e barna mjekësore të forcave ushtarake shqiptare në zonat e veprimeve. Shtabi merrej me organizimin e forcave dhe strukturave të Ushtrisë, me hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve mbi organizimin, jetesën, stërvitjen dhe veprimtarinë e Ushtrisë dhe të Xhandarmërisë Shqiptare. Pas 24 majit 1944, me unifikimin e Komandës në Komandë të Përgjithshme, me një Komandant të Përgjithshëm në Krye, Shef i Shtatmadhorisë u emërua gjeneralmajor Spiro Moisiu. Shtabi i Përgjithshëm vijoi të mbetej si një organ i specializuar ushtarak, që kryente detyra të ngjashme si dhe më parë. Me çlirimin e vendit, në 1944, ashtu si gjithë UNÇSH-ja, edhe Shtabi i Përgjithshëm iu nënshtrova shndërrimeve të domosdoshme për një ushtri të rregullt të kohës së paqes. Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes në vitet 1945-1990 është riorganizuar në varësi të drejtpërdrejtë të ecurisë së FA-ve, duke iu përgjigjur gjendjes, detyrave e strukturave të tyre. Riorganizimet, shërbimet e zhvillimet e Ushtrisë Shqiptare u mbështetën edhe në efektshmërinë e udhëheqjes operative-strategjike. Në këtë periudhë u përsos organi i drejtimit, Shtabi i Përgjithshëm. Për organizimin dhe drejtimin e Forcave të Armatosura, më 1 korrik 1945, u krijua Ministria e Luftës dhe e Mbrojtjes Kombëtare, ku në përbërje të saj vepronte Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Kombëtare. Shtabi i Përgjithshëm ishte në varësi të Komandantit Suprem, i cili ishte edhe i ngarkuari me punët e Luftës dhe të Mbrojtjes Kombëtare. Në varësi të Shtabit të Përgjithshëm ishin, Drejtoria e Mbrojtjes Kombëtare dhe Drejtoria e Ndërlidhjes dhe tetë seksione dhe më konkretisht Seksioni Operativ, i Informacionit, i Topografisë, i Shifrës, i Stërvitjes Luftarake, i Ekspeditës, i Aeronautikës, i Brendshëm. Komandat dhe drejtoritë e tjera vareshin drejtpërdrejtë nga Komanda e Lartë Supreme.

Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi, personalitet në Ushtrinë osmane, ish-komandanti i garnizonit të Stambollit me gradën “binbash”. Nënkolonel Ali Shefqet Shkupi ka qenë shef i Shtamadhorisë së parë Shqiptare me funksionet e komandantit suprem të ushtrisë shqiptare në qeverinë se Ismail Qemal Vlorës. Braktisi ushtrinë osmane kur ishte komandant i garnizonit të Stambollit.

Gjeneral Ali Riza Kolonja përveç detyrës si Ministër Luftë në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare në vitet '20, pas Kongresit të Lushnjës me Kryeministër Sulejman Delvinën, ka kryer edhe detyrën e Kryetarit të Shtabit Madhor si dhe njëherësh edhe detyrën e Komandantit të vetëm të Divizionit që kishte në atë kohë Shqipëria.

Major Xhavid Leskoviku ka lindu, më 2 maj 1882, në Leskovik. Ndoqi studimet në Akademinë e Luftës në Stamboll për degën e këmbësorisë (Pyade). Dhe është titulluar oficer, më 1



“112 Vjet Lavdi dhe Sakrificë – Shtabi i Përgjithshëm, Zemra e Ushtrisë Shqiptare!”

gusht 1907, duke shërbyer për gjashtë vjet me radhë në ushtrinë osmane në disa detyra. Por, më 1 janar 1913, hyn në shërbim të Ushtrisë Kombëtare shqiptare. Ai shërbeu në qeverinë e Ismail Qemal bej Vlorës si dhe në ushtrinë e Vilhelm Vedit.

Major Bajram Fevziu ka qenë i njohur si një nga drejtuesit e Shtabit Madhor, por njëherësh edhe si personalitet politik i botës shqiptare së cilës i përket.

U shqua për besnikëri, atdhetarizëm, vendosmëri dhe aftësi ushtarake. Me gradën major zëvendësoi Xhavit Leskovikun në postin e kryetarit të Shtabit Madhor të Ushtrisë Shqiptare. Këtë post ai e mbajti edhe me ardhjen e Qeverisë së Fan Nolit. Në krye të Shtabit Madhor, major Fevziu qëndroi deri më 24 dhjetor 1924.


Gjeneral Gustav Von Myrdac me origjinë austriake ishte në



postin e kryetarit të Shtabit madhor, i cili kryente njëherësh edhe detyrën e organizatorit të Ushtrisë Shqiptare, që e mbante qysh prej vitit 1922. Ai kishte lindur më 7 dhjetor 1876, në Vjenë, kryeqytet i Austro-Hungarisë. Më 18 janar 1925, me riorganizimin e UKSH, Myrdac emërohet Kryetar i Shtatmadhorisë dhe organizatori kryesor i UKSH-së. Në vitin 1933 i jepet grada “gjeneral”, që me këtë gradë punoi për UKSH-në deri me pushtimin e Shqipërisë në vitin 1939. Ai rishfaqet përsëri në kohën e pushtimin në tendencat për ngritjen e ushtrisë së pavarur shqiptare nën drejtimin e Komandës së Mbrojtjes Kombëtare, që me pushtimin gjerman u emërtua “Komanda Shqiptare e Mbrojtjes”.

Gjeneral Spiro Moisiu lindi në vitin 1900 në qytetin e Kavajës. Moisiu mori pjesë në përbërje forcave qeveritare që u caktuan në mbrojtje të Kongresit të Lushnjës dhe po atë vit ai u caktua me detyrën e shefit të Shtabit të grupit në luftimet që u zhvilluan në Kaptinë të Martaneshit kundra forcave serbe. Në Kryengritjen e Qershorit të vitit 1924, Spiro Moisiu u rreshtua përkrah ushtarakëve të komanduar nga kolonelët Rexhep Shala dhe Kasëm Qafzezi, të cilët u bashkuan me forcat fanoliste. Po kështu në dhjetorin e vitit 1924, Moisiu mori pjesë me forcat qeveritare që dolën në Shkallën e Tujanit për të penguar kthimin e Zogut në Shqipëri. Duke pasur parasysh të kaluarën e tij të papërlyer dhe aftësitë e rralla si ushtarak i karrierës, në korrikun e vitit 1943, krerët e Partisë Komuniste e thërritën atë në Labinot të Elbasanit, ku dhe i propozuan detyrën e Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ai kishte famën e madhe që kishte krijuar Spiro Moisiu si Komandant i Përgjithshëm, në Kongresin e Përmetit, por të gjitha funksionet u përqendruan te funksioni politik si Komandant edhe Komisar i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ; ndërsa Spiro Moisiu mbajti vetëm detyrën e Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm.

Gjeneralkolonel Mehmet Shehu lindi më 10 janar 1913, në fshatin Çorrush të Mallakastrës. Gjatë Luftës Nacional-Çlirimtare ka qenë komandant i Çetës Plakë të Mallakastrës në shkurt 1943; komandant i Br1S në gusht 1943, Komandant i D1S në maj 1944 me gradën “kolonel”, ndërsa në tetor 1944 gradohet “gjeneralmajor”. Mbas çlirimit të Shqipërisë dërgohet për studime në Bashkimin Sovjetik, më pas emërohet Shef i Shtabit të Përgjithshëm. kryen njëkohësisht detyrën e zëvendëskryeministrit dhe atë të ministrit të punëve të brendshme. Kryeministër; ndërsa



nga 1974 deri në 1981 ka qenë Ministër i Mbrojtjes. Njohës i pesë gjuhëve të huaja: anglisht, frëngjisht, italisht, spanjisht dhe rusisht.

Gjenerallejtënant Beqir Balluku lindi më 14 shkurt 1917 në Tiranë. U përfshi në lëvizjen komuniste qysh gjatë kohës që kryente shërbimin ushtarak 1940 deri 1942. Më 20 maj 1943 u caktua komandant i batalionit partizan “Krujë-Ishëm”, më 18 shtator 1943, komisar i brigadës së tretë dhe më pas komandant i Br2S. Më 28 janar 1948 ishte emëruar kryetar i Shtatmadhorisë së Ushtrisë. Kreu në Moskë Akademinë Ushtarake “Voroshilov”. Në kongresin e parë të Partisë u zgjodh anëtar i Byrosë Politike dhe në vitin 1953, Ministër i Mbrojtjes Popullore. Një vit më pas mori gradën më të lartë në Shqipëri, atë të “gjenerallejtënantit”. Balluku ishte gjithmonë deputet i Kuvendit Popullor. Në korrik të vitit 1974, ai u akuzua si organizues i veprimtarisë puçiste ushtarake nga diktatura dhe u dënua me vdekje dhe u pushkatua më 5 nëntor 1975, për tradhti të lartë ndaj atdheut.

Gjenerallejtënant Arif Hasko Mema lindi në Tërbaç të Vlorës, i njohur gjatë LIIB me pseudonimin “Patrioti”, gjatë luftës për çlirimin e vendit. Në dhjetor të 1943-it, inkadrohet në BrIS, duke kryer detyra të ndryshme, deri komisar politik i kësaj brigade. Mbas çlirimit kryen Akademinë e Lartë të Shtabit të Përgjithshëm në Bashkimin Sovjetik. Më vonë kryen detyra të larta si Komisar Divizioni, Korpusi, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë dhe Zëvendësministër i Mbrojtjes Popullore. Ai tërë jetën e tij qëndroi besnik i idealeve të LANÇ-it. Ai kreu detyrën e zëvendëskryetarit të Parë të Komitetit Kombëtar të Organizatës së Veteranëve të LANÇ-it. Për kontributet e tij është nderuar me shumë urdhra e medalje të akredituara nga ish-Presidiumi i Kuvendit Popullor.

Gjenerallejtënant Petrit Dume lindi më 20 maj të vitit 1920, Deputet, i arsimuar me dy akademi sovjetike ushtarake, shef



i shtatmadhorisë së Forcave të Armatosura të Shqipërisë si shefi më jetëgjatë në Shtabin e Përgjithshëm. Ai ka qenë deputet në të gjitha legjislaturat.

Sami Meçollari ishte Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, për një periudhë të shkurtër në vitin 1974; ka qenë drejtues i spikatur i Formacioneve të mëdha ushtarake. Lindi në Marjan të Oparit në Korçë, më 10 mars 1937. Në periudhën 1970-1972 u caktua shef i Shtabit të Korpusit të Gjirokastrës. Në vitin 1973 mori detyrën e komandantit të këtij korpusi deri në vitin 1974, kur u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare.

Veli Llakaj ka lindur më 18 shkurt 1935, në Kras të Tepelenës. Në vitet 1967-1968, oficer drejtimi pranë SHP; Në vitet 1968-1971 ishte komandant i BriK, Tiranë. Në vitet 1971-1972, në Akademinë e SHP dhe Komandant i Korpusit të Burrelit. Në vitet 1972-1974 ishte komandant i Korpusit të Parë të Mbrojtjes Bregdetare Fier. Në vitin 1974 emërohet zëvendësministër i Parë dhe shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë, detyrë të cilën e



kryen deri në vitin 1982. Kiço Mustaqi ishte një ushtarak karriere që kishte lindur, më 22 mars 1938, në një fshat pranë Delvinës, Sarandë. Në detyrën e Ministrit të Mbrojtjes vjen pasi kishte kryer detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare për nëntë vjet rresht. Në shkurt të vitit 1991, ngarkohet me detyrën e Ministrit të Mbrojtjes të Shqipërisë në përbërje të qeverisë së Kryeministrit Fatos Nano dhe u largua nga detyra me dorëheqjen e qeverisë në qershor të po atij viti.

Kolonel Halim Abazi ka lindur në dhjetor të vitit 1944 në Tërbaç të Vlorës. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në Shkurt-Qershor 1991, u përzgjodh për detyrën e lartë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë shqiptare. Ka dalë oficer në rezervë në vitin 1993.

Gjeneralmajor Kostaq Karoli ka lindur në dhjetor të vitit 1945, në Korçë. Ka qenë ushtarak i talentuar, ka kryer të gjithë llojet e arsimimit ushtarak shqiptar, të cilat i ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera. Në qershor 1991 deri në gusht 1992 ka kryer detyrën madhore të Shefit të SHP.

Gjeneral Ilia Vasho ka lindur më 10 korrik 1944, në Leskovik. Mbante gradën shkencore “Dr.Sh”. Në 1992-1994 u përzgjodh për detyrën e lartë të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare. Dalë oficer në rezervë në vitin 1997, nga funksioni që ka pasur si përfaqësues ushtarak në NATO, funksion që e kreu nga 1994 deri në 1997.

Gjeneral me katër yje Sheme Kosova. Në periudhën 1994-1997 ka kryer detyrën madhore Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Sheme Kosova ishte lindur në 24 mars 1949. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare deri në Shef i SHPFASH.

Gjeneralmajor Adem Çopani ka lindur në korrik të vitit 1944 në Tiranë. Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake. Në vitet 1991 deri në mars 1997 ka kryer detyrën e Këshilltarit ushtarak të Presidentit të Republikës. Në një nga periudhat më të vështira e të errëta të ushtrisë shqiptare, në mars të vitit 1997 zgjidhet në postin madhor të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, detyrë që e mbajti deri në gusht të vitit 1997.

Gjeneral brigade Aleks Andoni ka lindur më 8 qershor 1956, në fshatin Vuno të Vlorës.

Ka kryer detyra të nivelit më të lartë në ushtrinë shqiptare, përfshi edhe ato në nivelet e shkollave ushtarake.

Gjenerallejtënant Pëllumb Qazimi ka lindur në vitin 21.10.1957 në Skrapar. Ka kryer detyrat: komandant toge, instruktor stërvitje; Zëvendësdrejtor në drejtorinë e zbulimit në Shtabin e Përgjithshëm, grada nënkolonel; Zëvendësdrejtor i Shërbimit Informativ Ushtarak dhe shef i Zbulimit Ushtarak, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Gjeneralmajor Luan Hoxha ka lindur më 28 mars 1960, në Shkodër dhe ka qenë Shef i Shtabit të Përgjithshëm i Forcave të Armatosura nga viti 2006-2008.

Gjeneralmajor Maksim Malaj ka lindur në 13.12.1958. Gjatë periudhës që Maksim Malaj ka qenë në krye të FASH, ka pasur një progres të dukshëm ku Shqipëria është pranuar anëtare me të drejta të plota në strukturën e sigurisë së kombeve, NATO.

Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi ka lindur në Peshkopë, më 30 janar 1963. Me dekret të Presidentit të Shqipërisë Nr.7079, datë 8 gusht 2011, u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm.

Gjeneralmajor Jeronim Bazo ka lindur më 1960, Drejtoi Shtabin e Përgjithshëm nga 3 nëntori 2013 deri në janar 2017.

Gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku është lindur në Pëllumbas të Beratit më 1967. Ka kontribuar për ngritjen në një shkallë më të lartë të stërvitjes e modernizimit të FA-së, për forcimin e kapaciteteve dhe përmbushjen e objektivave strategjike në kuadrin e direktivave të NATO-s. Forcat e Armatosura nën drejtimin e tij u angazhuan për ngritjen e niveleve cilësore ushtarake nëpërmjet shndërrimit në një forcë profesioniste, të mirë stërvitur, të pajisur me sisteme të teknikës dhe të armatimit bashkëkohor si një proces i modernizimit të FA-së në vijimësi.

Gjeneralmajor Bajram Begaj është lindur më 20 mars 1967, në qytetin e Rrogozhinës. Në vitin 2020, një muaj pas gradimit si “gjeneralmajor”, shërbeu si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ka përfunduar studimet doktorale dhe është autor i disa publikimeve shkencore. Nga viti 2016, mban gradën shkencore “Prof. Asoc”. Aktualisht është Presidenti i 8-të i Republikës së Shqipërisë, që prej 24.7.2022.

Gjenerallejtënant Arben Kingji është lindur më 22 dhjetor 1970, në Kukës. Ka shërbyer si komandant i kontingjentit shqiptar në Irak, Afganistan. Pas diplomimit ka shërbyer komandant toge, Instruktor taktik, Drejtues i Grupit Special në Batalionin Komando, Zëvendëskomandant i Batalionit të Forcave Speciale, Komandant i Batalionit të Policisë Ushtarake, Komandant i Forcës Tokësore, ka shërbyer në katër misione jashtë vendit si komandant i kontingjentit Shqiptar në Afganistan si dhe Komandant i kontingjentit Shqiptar në Irak.

GJERGJ KASTRIOTI – SKËNDERBEU

Figura Qendrore e Identitetit Kombëtar Shqiptar, në Përvjetorin e Lindjes së Tij

Mbushen 620 vite nga lindja e Heroit të kombit Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, figura më e shquar në historinë e shqiptarëve, i cili njihet si themelues i shtetit mesjetar-shqiptar.

Ai u lind, më 6 maj të vitit 1405, dhe vdiq më 17 janar 1468. Ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit, që ishte marrë peng si nizamë pas thyerjes së të atit nga Sulltan Murati, më 1421 dhe u dërgua në oborrin e Sulltanit në Adrianopojë. Atje, zgjuarsia dhe shkathtësia e çuan Gjergjin në shkollën e sulltanit (içogllanëve) që përgatiste komandantë e nëpunës. Natyra i kishte dhënë dhunti mendore e fizike. Atje mori emrin Iskënder (Aleksandër).

Pas mbarimit të shkollës, Gjergj Kastrioti (Skënderi) kreu detyra ushtarake në Ballkan e në Azinë e Vogël, duke u dalluar për trimëri dhe për këtë arsye iu dha titulli ‘bej’ që do të thotë princ ose fisnik, pra Skënderbeg do të thotë Aleksandri princ ose fisnik. Ai nuk e harroi vendin e tij dhe priste me padurim rastin të kthehej në tokën që e lindi. Me vdekjen e të atit, ai shpresonte t’i zinte vendin, por në fakt sulltani e emëroi sanxhakbej jashtë tokave shqiptare.

Skënderbeu nuk hoqi dorë nga ideja për t’u kthyer në Shqipëri në fronin e të atit, deri në vitin 1443, kur ai u nis kundër Janosh Huniaditnën komandën e bejlerbeut të Rumelisë.

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Legjenda e lindjes së një legjende që mbeti legjendar në vetëdijen tonë kombëtare

Vepra dhe emri i të cilit do të shndërrohej në legjendë, do t’i përkiste përjetësisë, siç ishte dhe mbeti të gjallët e tij nga më të zëshmit kushtrime të ekzistencës sonë në histori. Thonë se kur e ëma, Vojsava, mbeti shtatzënë me të, pa në ëndërr se lindi një dragua aq i madh, saqë mbulonte gati gjithë Epirin, kokën e shtrinte ndërmjet kufijve të Turqisë, të cilët i përpinte me gurmazin e vet të gjakosur, ndërsa bishtin e mbante në det, ndërmjet kufijve të krishterë dhe sidomos të shtetit venedikas.

Gjon Kastrioti, me t’iu rrëfyer ëndrra, e qetësoi me gëzim të madh të shoqen, dhe e profetizoi se prej saj do të lindte një burrë i përmendur në luftë e në vepra, i cili do të ishte armiku më i rreptë i turqve dhe kapedani i tyre më fatbardhë, mbrojtës i fesë së krishterimit dhe nderues i përhershëm i pushtetit venedikas. Mes të vërtetës dhe trillit është një kufi ndarës, shpesh i padukshëm, imagjinari si një sprovë e kureshtisë dhe ëndjes që sëmbon njohjen dhe përjetimin e atyre ngjarjeve, atyre episodeve që në vetvete përbëjnë vetë historinë e epokës së ndritur të Skënderbeut.

Skënderbeu ishte një e vërtetë e ndritshme në sytë tanë dhe në historinë e botës. Ai është një kapitull sakrificash dhe lavdie, luftërash të përgjakshme dhe përpjekjesh të paepura për të dëshmuar të drejtën e triumfit.

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu është, pa dyshim, ashtu siç e ka përcaktuar, më 1925, historiani i dëgjuar kroat Milan Šufflay “krijesa më hyjnore e kësaj race më të tmerrshme luftëtare, i cili që kur ishte gjallë u madhërua me legjenda të ndryshme nga Evropa Perëndimore. Arsyeja e këtij madhërimi të veçantë rrjedh: ngase Skënderbeu në krye të shqiptarëve përballoi furinë osmane në një kohë kur Evropa përjetonte një nga momentet më kritike të historisë së saj mesjetare.

Ky ishte Gjergj Kastrioti – Skënderbeu, të tilla ishin dhe mbeten përmasat e kësaj figure emblematike të identitetit tonë kombëtar, jeta dhe vepra e një figure që arriti të thithte interesin e gjithë botës dhe krishterimi të kishte tek arbri i madh, Kalorësin e Krishtit.

Historia e Skënderbeut është themeli i të gjithë historive, të cilat tregojnë shtegun për nga ka kaluar populli ynë në udhën e gjatë të qëndresës dhe qytetërimit, rrugëtim i cili është i shtruar me sakrificat më sublime dhe blatimet më të shenjta. Figura e Heroit Tonë Kombëtar, Gjergj Kastrioti – Skënderbeu është një nga më madhështoret e gjithë asaj rrëfenje që ka ardhur deri në ditët tona. Nuk kishte më të lavdishme deri atëherë dhe nuk do të kishte deri tash një gjurmë yjesh në shkreptimën e shëmbëllimit të dritës së hyjnisë. E tillë është historia e këtij zemërluani, mendjendrituri dhe strategu të shquar të artit të luftës. Të tilla janë bëmat dhe trimëritë, urtësitë dhe gjenialitetet e zgjidhjeve vendimtare për fatin e luftës dhe lirisë. Ai ka kapluar kufijtë e



legjendës, sepse e këtyre përmasave ishte ardhja e tij.

Më 3 nëntor 1443, në afërsi të Nishit, u ndeshën dy ushtritë. Ushtria osmane u shpartallua dhe u tërhoq në panik. Skënderbeu filloi të zbatonte planin e kryengritjes. Së bashku me 300 kalorës shqiptarë e me të nipin Hamza Kastrioti, u kthye në Dibër, ku

populli e priti si çlirimtar.

Mori masa për përforcimin e rrugëve nga mund të vinin osmanët, dhe prej andej iu drejtua Krujës. Me një ferman të rremë shtiu në dorë qytetin e garnizonin dhe kështu, më 28 nëntor 1443, u shpall rimëkëmbja e principatës së Kastriotëve. Mbi kështjellën e Krujës u ngrit flamuri me shkabën e zezë dykrenare i Kastriotëve. Kryengritja u përhap shpejt në viset e tjera dhe feudalët e tjerë u ngritën gjithashtu. Gjatë dhjetorit, Shqipëria e Mesme dhe e Veriut u spastruan nga forcat osmane, u çliruan njëra pas tjetrës kështjellat e kësaj zone.

Skënderbeu ishte organizatori i Kuvendit të Arbrit, në të cilin u zgjodh si prijës i Lidhjes Shqiptare të Lezhës. Ai u martua me të bijën e Gjergj Arianitit, Donika Arianitin për të forcuar lidhjet e tij me principatat e tjera. Në janar të vitit 1468, Skënderbeu u sëmur gjatë zhvillimit të një Kuvendi të thirrur nga ai, në të cilin ishin të ftuar të gjithë princat shqiptarë. Vdiq më 17 janar 1468, në Lezhë, ku edhe u varros. Shqiptarët humbën prijësin e lavdishëm që i udhëhoqi për 25 vjet rresht. E shoqja me të birin emigruan, sikurse edhe një pjesë e parisë shqiptare, për në Itali. Rreth përkrenares ekziston ideja se e ka mbajtur për nder të Pirros së Epirit, pasi edhe ai ka mbajtur po të njëjtën përkrenare.

Epoka e Skënderbeut e shekullit XV dhe vetë figura e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut ndikoi fuqishëm në jetën shpirtërore të shqiptarëve dhe për rritjen e vetëdijes kombëtare të tyre.

Të frymëzuar prej tyre, intelektualë të shquar shqiptarë, i pasqyruan e i përjetuan ato në vepra historike monumentale, në të cilat nisi jetën e vet historiografia shqiptare. Historia tregon se për shumë kohë shqiptarët e mbajtën të fshehtë lajmin e vdekjes së Skënderbeut, por edhe kur e dëgjuan as vetë turqit nuk e besonin se ai kishte vdekur. Shqiptarët e fituan edhe një betejë pa Skënderbeun, betejën e Kirit, udhëhequr nga Lekë Dukagjini. Por pas 10 vjetësh, kur turqit nisën sërish pushtimin, e gjetën varrin e Skënderbeut dhe morën eshtrat e tij, duke i përdorur ato si hajmali për t’u dhënë forcë dhe fitore, ashtu sikundër ai ishte i gjallë.

STRATEGJIA E RE E NATO-S: PËRDORIMI I TË DHËNAVE PËR TË FORCUAR MBROJTJEN KOLEKTIVE

NATO publikoi një version publik të Strategjisë së saj të parë të të Dhënave. E miratuar nga Aleatët në shkurt 2025, strategjia synon të përshpejtojë mënyrën se si Aleanca përdor të dhënat për të ndihmuar në arritjen e ndërveprimit dhe integritetit në të gjitha fushat operacionale.

